



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER FATMIR LAÇEJ
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 7, RRUGA KAVAJES, PALLATI
NR. 203
TEL: 0672037222

REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 536

Nr. koleksioni: 157

Tirane më 29/01/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"


²Akti noterial përbëhet nga 29 fletë



A2022053830016248425



A.2022053830016248425

**AKTI I THEMELIMIT****I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR****"FINBALKAN" shpk**

Sot, më datë 29/01/2022 (Dymijenezetedy), para meje Noter FATMIR LAÇEJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 7, RRUGA KAVAJES, PALLATI NR. 203, u paraqit personalisht:

THEMELUESI:

RENATO BONORA, atësia Lorenzo, shtetas Italian, lindur në Finale Ligure (SV) dhe banues në TIRANE, me adresë Tirane, lindur më 20/11/1947, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Karte Identiteti Italiane nr. CA71600DB .

Pasi kam konstatuar se ka të gjitha cilesite e ligjit, (madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar), me kërkesen dhe vullnetin e tij të lire dhe të plotë, redaktoj këtë AKT THEMELIMI si më poshtë vijon

AKTI I THEMELIMI**I SHOQËRISË "FINBALKAN" shpk**

KRIJIMI, FORMA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, EMERTIMI, SELIA

NENI 1**KRIJIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **"FINBALKAN" " shpk "** krijohet në bazë të aktit të themelimit nga ortaku i mëposhtëm:

Z. Renato BONORA, biri i Lorenzos, lindur më 20/11/1947, në Itali, banues në Itali, me Karte Identiteti italiane Nr. CA71600DB

I cili sot krijon shoqërinë e emërtuar "FINBALKAN" shpk

Shoqëria është person juridik shqiptar dhe gëzon të drejta e detyrime si person juridik shqiptar, që prej datës në të cilën kryhet regjistrimi i saj në QKB.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese (Akte themelimi dhe Statut).

NENI 2**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Veprimtaria e shoqërisë do të përmbajë :

- Realizimin e studimeve dhe kerkimeve në fushën juridike, të organizimit të ndërmarrjes, marketing, administrativ, tributar, si dhe informatik në sektorin publik e privat, me përjashtim të profesioneve të rezervuara e të mbrojtura ;
- Veprimtari në fushën ekonomike të ndërmarrjeve me vëmendje të veçantë kontrollit të menaxhimit dhe biznesit të thjeshtë si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat;



A2022053830016248425

- ndihma për entet publike për zhvillimin ekonomik , me referencë të veçantë planifikimeve dhe realizimeve të planeve industriale, artizanale , tregtare në zonat me lehtësira financiare , me përjashtim të profesioneve të rezervuara e të mbrojtura ;
- ndihma për organet publike në zbatimin e sistemeve të kontabilitetit dhe mjeteve përkatëse të kontrollit të menaxhimit, si dhe të gjithë atyre mjeteve statistikore (p.sh. bazat e të dhënave) të nevojshme për kryerjen e duhur të veprimtarive të përgjithshme të menaxhimit të vetë institucioneve;
- zhvillimi i një programi specifik për organet publike dhe private në kontabilitet, kontroll të menaxhimit dhe këshillimit të biznesit;
- realizimi dhe shpërndarja e botimeve editoriale në fushën juridike dhe afariste-ekonomike, edhe nepermjet kanaleve elektronike, si dhe studimin dhe krijimin e faqeve të internetit;
- promovimi, organizimi dhe / ose menaxhimi, vetë ose në emër të palëve të treta, me personelin e tij dhe / ose me ndihmën e palëve të treta, sidhe seminare për trajnimin dhe kualifikimin profesional të sipërmarrësve, menaxherëve, zyrtarëve publik, përfshirë organet e shkallës së dytë, të punonjësve të afërm dhe të të gjitha kategorive të interesuara për problemet e lidhura
- administrimi i biznesit, publik-privat, me referencë të veçantë për çështjet e pikave a) dhe b) të këtyre qellimeve të shoqërisë ;
- studim i personalizuar i logove, broshurave prezantuese dhe çdo mjeti tjetër tregtar për institucionet publike dhe private;
- Veprimtari e kontroll i ndermarrjeve , vlerësimet e kompanive dhe kuotave të shoqërisë, rishikimi dhe kontroll i llogarive , administrativ, financiar, me efikasitet të jashtëzakonshëm dhe periodik të shoqërisë gjithashtu dhe për llogari të autoriteteve gjyqësore;
- studimi i disiplinave ekonomike, juridike, fiskale, të punës dhe administrative që përfaqësojnë parakushtet thelbësore për arritjen e qëllimeve të përshkruara më lart me përjashtimin e veprimtarive profesionale të mbrojtura. Shoqëria për arritjen e objektivave mund të ndermarre dhe lidhje marreveshjes , ndërmarrje të përbashkëta me universitete publike ose private, sidhe institute profesionale, për realizimin e studimeve, projekteve dhe eksperimente që përfshijnë studentë dhe mësues gjithashtu përmes promovimit të bursave specifike.
- Shoqëria për arritjen e qëllimeve të saj mund të kryej veprime tregtare , financiare, industriale, mobiluar dhe imobiliare; mund të japë garanci edhe në favor të të tregtarëve vetëm për qëllimin e një investimi të qëndrueshëm dhe jo futjen në treg, si direct dhe indirect , pjesëmarrje në shoqëri të tjera. Shoqëria mund të marrë kredi të zakonshme bankare, të lehtësuara si dhe leasing dhe kredi në monedha të huaja

NENI 3

FORMA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë që Asambleja e Ortakëve nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj në një shoqëri tjetër.

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozita përkatëse të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 4

EMERTIMI

Ortaku ka vendosur që shoqërinë të emërtojë **"FINBALKAN" shpk** në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria , emertimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalet shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe inicialet SHPK.



A2022053830016248425

N E N I 5

KOHEZGJATJA

Shoqëria do të ketë një periudhë aktiviteti të pakufizuar

N E N I 6

SELIA

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, Rr. Kavajes , Pall 136

Përveç veprimtarisë në nivel lokal shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve ,agjensive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një vendim të Asamblesë së Ortakëve

N E N I 7

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar i shoqërisë përbehet nga të holla në vlefte 10.000(dhjetemije)leke , nga të cilat :

Nr	Emri Mbiemri ortakëve	Pjese ne kapitalin	% ne kapital themeltar	Vlera Ne Leke
1	Renato BONORA	1 PJESE	100 %	10.000 (dhjete mije) Kapitali është shlyer e nënshkruar teresisht .

Kuota e kapitalit fillestar është derdhur nga ortakët themelues në Bankë dhe është shënuar në librin e llogarive të shoqërisë

Ortakët në të ardhmen mund të rrisë apo zvogëlojë kapitalin themeltar të shoqërisë.

N E N I 8

LLOGARIA E SHOQËRISË

Viti ekonomik mbyllet në 31 Dhjetor të çdo viti dhe bilanci duhet të miratohet brenda tre muajve të vitit pasardhës.

N E N I 9

ADMINISTRIMI

Administrimi i shoqërisë do të kryhet në bazë të dispozitave të statutit të shoqërisë , që është pjesë përberëse e këtij akti themelimi.

Detyrën e Administratorit të shoqërisë për një afat pesëvjeçar do të kryejë Z. Renato BONORA .

N E N I 10



A2022053830016248425

DISPOZITA TE FUNDIT

Per ceshnje te cilat nuk jane parashikuar ne kete akt themelimi ortakut do ti referohet dispozitave perkatese te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".


Akti I themelimit redaktohet ne tre ekzemplare , ne tre faqe , ju lexua ortakut me ze te larte dhe te qarte, iu perkthye prej meje nga gjuha shqipe ne gjuhen italiane dhe si e gjeti sipas vullnetit te tij te lire dhe te plote e nenshkroi ate pa verejtje dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit .

ORTAKU I SHOQERISE

Renato BONORA

NOTERI

Fatmir LAÇEJ



Perktheu
Fatmir Laçej

